



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

MARS, 2025

Buletini Muja i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin mars 2025 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe rastet e dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit mars 2025 zënë 22 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 166.6/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 3.2/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin mars 2025 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin mars 2025 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste mars 2025	Incidenca mars 2025 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	5	0.17
Shigelozë (Disenteri bacilare)	7	0.24
Dizenteri amebike	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	93	3.25
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	4664	162.9
Sëmundje diarreike në total	4769	166.6

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit mars 2025 janë raportuar në total 205 raste variçelë (incidenca 7.2/ 100.000 banorë) nga të cilat, 117 raste janë të dyshuara dhe 88 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 70 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 4-9 vjeç me 71 raste, grafiku 1.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës



2.2 Fruthi


Gjatë muajit mars janë raportuar 17 raste të dyshuar me fruth nga të cilat janë konfirmuar 10 (58.8%) raste nga ana laboratorike si pozitiv me virusin e fruthit.

Incidenca e fruthit për muajin mars është 0.42 raste/ 100000 banorë. Prej rasteve të konfirmuar 6 (60%) janë të gjinisë mashkull dhe 4 femra (40%).

Tabela 2. Shpërndarja e rasteve sipas muajve

Muaj	Nr. rastesh	Incidenca
Janar	1	0.04
shkurt	3	0.12
Mars	10	0.42

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve sipas datës së fillimit të rashit



Rastet e muajit mars i përkasin grup-moshave pediatrike përkatësisht nga 1-14 vjeç. Ata kanë qenë të shtruar në spital me shenja të fruthit. Nga 10 rastet e konfirmuara, 7 janë të pavaksinuar, 2 raste me një dozë vaksine dhe 1 rast me 2 doza (14 vjeç nga Tirana).

Dy raste janë banorë të bashkisë Tiranë dhe 8 raste të bashkisë Fier. Nga ana e shërbimit epidemiologjik pranë çdo bashkie është kryer hetimi në vatër për rastet, dhe janë marrë masat e kontrollit për ndërprerjen e transmetimit të virusit.

3. Hepatitet virale


Hepatiti viral B (HBV)

Në muajin mars janë raportuar 51 raste të dyshuar nga të cilat janë konfirmuar 29 (57%) raste me HBV. Incidenca e HBV-së në muajin mars është 1.2 raste/100 000 banorë në vend. Prej tyre 16 janë të gjinisë mashkull (55%) dhe 13 femra (45%).

Tabela 3. Shpërndarja e rasteve sipas muajve


Muaj	Incidenca	Nr. rastesh
Janar	0.8	20
Shkurt	1.4	34
Mars	1.2	29

Grafiku 3. Shpërndarje e rasteve me HBV sipas bashkive dhe muajve



Në muajin mars rastet janë të shpërndara në disa bashki (Grafiku 3), ku numrin më të lartë e ka Elbasani (6 raste).

Grafiku 4. Shpërndarje e rasteve me HBV sipas grup-moshave (vite)



Rastet në muajin mars i përkasin grup-moshës adulte mbi 30 vjeç (grafiku 4) dhe mungesa e tyre në grup-moshat pediatrike, kjo në sajë të vaksinimit ndaj HBV në këto grup-mosha.


Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin mars janë raportuar 18 raste të dyshuar nga të cilat janë konfirmuar 6 (33%) raste me HCV. Incidenca e HCV për këtë muaj është 0.25 raste /100000 banorë. Prej tyre 4 (67%)janë të gjinisë mashkullore dhe 2 femra (33%).

Tabela 4. Shpërndarja e rasteve sipas muajve


Muaj	Raste	Incidenca
Janar	3	0.12
Shkurt	5	0.21
Mars	6	0.25

Grafiku 5. Shpërndarje e rasteve me HCV sipas bashkive dhe muajve



Rastet i përkasin bashkisë Divjakë, Durrës, Elbasan, Finiq dhe Tiranë (grafiku 5).

Grafiku 6. Shpërndarje e rasteve me HCV sipas grup-moshave (vite)




Rastet janë të grup-moshave adulte mbi 35 vjeç (grafiku 6)

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS


Gjatë muajit mars 2025 janë kryer 43 ekzaminime për HIV (28 meshkuj dhe 15 femra) prej të cilëve 8 raste (7 meshkuj dhe 1 femër) kanë rezultuar HIV pozitiv (grafiku 7).

Grafiku 7. Shpërndarja e testeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin mars 2025



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv në muajin mars është: 1 rast në Durrës, Elbasan 1 rast, Korçë 1 rast dhe 5 raste Tiranë (nga të cilët 1 rast është me shtetësi të huaj). (Grafiku 8)

• **Grafiku 8. Shpërndarja gjeografike e rasteve të konfirmuara në muajin mars 2025**



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 16-24 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 25-34 vjeç, 4 raste i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç dhe 1 rast i përket grup-moshës 55-64 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur 2 raste nga klinika ambulatorë (me banim në Korçë dhe Tiranë), 4 kanë ardhur nga laboratorë/spitale private (1 rast – INTERMEDICA, 1 rast nga Spitali Continental dhe 2 raste – GENIUS), 1 rast nga VCT Elbasan dhe 1 rast nga NJVKSH Durrës.

Gjatë muajit mars 2025 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 5 raste të konfirmuara me Sifiliz.

Rastet e raportuara, të konfirmuara, janë 2 meshkuj dhe 3 femra. Shpërndarja sipas grup-moshave është 3 raste për grup-moshën 25-34 vjeç, 1 rast për grup-moshën 15-24 vjeç dhe një rast sifiliz kongenital.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit mars 2025 janë raportuar gjithsej 14 raste me tuberkuloz (TB). Të 10 rastet janë pulmonarë dhe 1 rast ekstrapulmonar. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara pozitiv. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 5 në Tiranë, 1 në Pogradec, 1 në Dibër, 1 në Shkodër dhe 2 në Vlorë. Rastet ekstrapulmonare janë: 3 në Tiranë dhe 1 në Lezhë. Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për

të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 5: Shpërndarja e zoonozave në muajin mars 2025, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciziozë)

	Mars (raste 2025)	Incidenca (raste/100,000) 2025
Antraks (Plasje)	3	0.10
Brucelozë	4	0.14
Leptospirozë	1	0.03

Për muajin mars janë raportuar 4 raste Brucelozë përkatësisht: 2 në Tepelenë, 1 në Delvinë dhe 1 në Roskovec. Gjithashtu, është raportuar edhe 1 rast i konfirmuar me Leptospirozë nga Korça dhe 3 raste Atraks nga Gjirokastra.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit


7.1 COVID-19

Gjatë muajit mars 2025 janë raportuar në sistemin e informacionit të sëmundjeve infektive 4 raste të konfirmuara me Covid-19 . Grup-moshat më të prekura për këtë muaj janë grup-mosha 50-70 vjeç. Rastet janë raportuar nga bashkia Tiranë.

7.2 Grip

Gjatë muajit mars janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 128 raste të konfirmuara me Grip, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin mars është 4.47 raste /100000 banorë. Grafiku 7 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të viruseve qarkullues. Vërehet mbizotërim i Gripit Tipi B.

Grafiku 7. Tipi i viruseve qarkulluese



Në muajin mars qarkullimi i gripit arriti intensitet mesatar duke paraqitur aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën, dhe përhapje gjeografike rajonale. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Meningit Bakterial Jo-Meningoskoksik

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit mars 2025 nga Spitali Infektiv Tiranë, është raportuar 1 rast i konfirmuar me meningit bakterial specifikisht *Streptococcus pneumoniae*.

Rasti është i grup-moshës 60-65 vjeç, gjinia mashkull nga Durrësi. Rasti është konfirmuar me *Streptococcus pneumoniae* në laboratorin mikrobiologjik të QSUT-së. Shërbimi i epidemiologjisë dhe i shëndetit mjedisor pranë NJVKSH Durrës ka bërë hetimin në vatër, dhe ka marrë masat përkatëse.